



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:241954

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06082806

**C.nr.535/22**

**Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve A.H.B.K.I.H.T.H.S.N.H të punësuar në SHFMU “Imer Krasniqi” në fshatin C., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Lumbardh Haxhaj dhe Av. Legjenda Haxhaj nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër të inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 23.08.2024 muar këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.H.B.K.I.H.T.H.S.N.H të punësuar në SHFMU “Imer Krasniqi” në fshatin C., Komuna e Malishevës

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, që në emër të inflacionit, t`ua paguaj paditësve si në vijim:

**Paditësit A.H.**

për periudhen gusht -dhjetorë 2019 në shumën prej **56.83 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2020 në shumën prej **10.10 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2021 në shumën prej **171.76 euro**,

për periudhen Janar-nëntor 2022 në shumën prej **537.19 euro** në total shumen prej **775.88 euro**;

**Paditësit B.K.**

për periudhen gusht -dhjetorë 2019 në shumën prej **56.83 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2020 në shumën prej **10.10 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2021 në shumën prej **171.76 euro**,

për periudhen Janar-nëntor 2022 në shumën prej **537.19 euro** në total shumen prej **775.88 euro**;

**Paditësit I.H.**

për periudhen gusht -dhjetorë 2019 në shumën prej **56.83 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2020 në shumën prej **10.10 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2021 në shumën prej **171.76 euro**,

për periudhen Janar-nëntor 2022 në shumën prej **537.19 euro** në total shumen prej **775.88 euro**;

#### **Paditësit T.H.S**

për periudhen gusht -dhjetorë 2019 në shumën prej **11.36 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2020 në shumën prej **10.10 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2021 në shumën prej **171.76 euro**,

për periudhen Janar-nëntor 2022 në shumën prej **537.19 euro** në total shumen prej **730.41 euro**;

#### **Paditësit N.H**

për periudhen gusht -dhjetorë 2019 në shumën prej **56.83 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2020 në shumën prej **10.10 euro**;

për periudhen Janar-dhjetorë 2021 në shumën prej **171.76 euro**,

për periudhen Janar-nëntor 2022 në shumën prej **537.19 euro** në total shumen prej **775.88 euro**,

të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 09.08.2022, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësve pjesërisht t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe shumën prej 20 euro në emër të taksës, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të paditësve në emër precizimit të padisë shumën prej 312.00 euro.

### **A r s y e t i m**

Paditësit A.H.B.K.I.H.T.H.S.N.H të punësuar në SHFMU “Imer Krasniqi” në fshatin C., Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarve të tyre Av. Lumbardh Haxhaj dhe Av. Legjenda Haxhaj nga Prishtina në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim mbi mjeteve në emër të inflacionit, sipas padisë paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “Imer Krasniqi” në fshatin C., Komuna e Malishevës, pasi që e paditura deri në ditën e parashtrimit të padisë, paditësve nuk i'a ka kompenzuar shtesën në emër të inflacionit, gjykatës i propozojnë të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkespadia e paditësve.

Të autorizuarit e paditësve përmes parashtrësës ka bërë precizimin e padisë ashtu që paditësit kërkojnë që të paguhet për çështjen e inflacionit për vitet 2019-2022, ashtu që për paditësin A. H. K. për 5 muaj të vitit 2019 ti paguaj shumën prej 56.83 euro, për vitin 2020 ti paguaj shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 ti paguaj shumën prej 171.76 euro, për vitin 2022 për periudhën kohore Janar-Nëntor ti paguaj shumën prej 537.19 euro dhe në shumë totale prej 775.88 euro, paditësës B.K.për 5 muaj të vitit 2019 ti paguaj shumën prej 56.83 euro, për vitin 2020 ti paguaj shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 ti paguaj shumën prej 171.76 euro, për vitin 2022 për periudhën kohore Janar-Nëntor ti paguaj shumën prej 537.19 euro dhe në shumë totale prej 775.88 euro, paditësit I.H.për 5 muaj të vitit 2019 ti paguaj shumën prej 56.83 euro, për vitin 2020 ti paguaj shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 ti paguaj shumën prej 171.76

euro, për vitin 2022 për periudhën kohore Janar-Nentor ti paguaj e prej 775.88 euro, paditësit T. H.- S. për 5 muaj të vitit 2019 ti paguaj shumën prej 56.83 euro, për vitin 2020 ti paguaj shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 ti paguaj shumën prej 171.76 euro, për vitin 2022 për periudhën kohore Janar-Nentor ti paguaj shumën prej 537.19 euro dhe në shumë totale prej 775.88 euro, paditësit N.H për 5 muaj të vitit 2019 ti paguaj shumën prej 56.83 euro, për vitin 2020 ti paguaj shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 ti paguaj shumën prej 171.76 euro, për vitin 2022 për periudhën kohore Janar-Nentor ti paguaj shumën prej 537.19 euro dhe në shumë totale prej 775.88 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t'ia paguaj shumën prej 312.00 euro, dhe në emër të precizimit të padisë shumën prej 312.00 euro euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi në këtë rast e lidhur me pagesën e inflacionit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive dhe në bazë të nenit 35 pika 10 e kësaj kontrate e vitit 2021, nuk kemi të dhëna çka dhe më të vërtetë duhet të paguhet ky inflacion apo në sa është përqindja dhe në këtë padi nuk ka prova konkrete zyrtare nga institucionet e Kosovës -BQK çfarë rritje ekonomike ka pasur në Kosovë dhe së qfarë përqindje të inflacionit duhet paguar dhe çka është paraparë në këtë rast. Konsiderojmë që rastin konkret kjo padi është bërë vetëm në bazë të supozimeve dhe nuk ka të bëjë asgjë me inflacion, pasi nuk ka të dhëna se ku duhet të mbështet kjo përqindje e rritjes së inflacionit dhe kjo norme e kontratës kolektive nuk zbatohet, poashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës, kolektive të arsimit kemi të bëjmë me parashkrim në bazë të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së dhe kjo si kërkesë padi është e pasaftshme pasi që ky borgj është kërkuar që nga viti 2017 , ndërsa padi është paraqitur në vitin 2022 pra këtë rast edhe po që se aprovet padia kemi të bëjmë me parashkrim, i ka propozuar gjykatës të refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin A.H.kontratën e punës nr.11/351 të datës 06.10.2015, për paditësin B. K. kontratën e punës nr.11/547 të datës 05.10.2017, për paditësin I.H.kontratën e punës nr. 11/1152 të datës 24.09.2018, për paditësin T.H.- S. kontratën e punës nr.11/18 të datës 26.01.2021 për paditësin N.Hkontratën e punës nr.11/393 të datës 06.10.2015, Listën e Pagës për të gjithë paditësit dhe Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të lëshuar nga Enti i Statistikave të Kosovës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura , ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqësve

rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të inflacionit, andaj nga provat e administruara, si dhe bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se **“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”**.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se **“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”**, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që **“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”** ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**.

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit në emër të inflacionit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënie të aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërit kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk**

*ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit të shujtave. Andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadiës së paditësve E. K., B. M., S. Sh. dhe R. Sh.- P., ndërsa sa i përket paditësit H. M. gjykata vendosi që të njëjtit t’ia aprovojë pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e tij, për periudhën e vitit 2019, pasi që i njëjti është pensionuar në vitin 2019, fakt të cilin e vërtetoi nga vendimi mbi pensionimin të datës 15.08.2019, ndërsa për periudhën e vitit 2020 dhe 2021 të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar duke u bazuar mbi faktet e lartpërmendura..

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësit padinë e kanë parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive nr.0113/2056 dt.18.04.2017 dhe Kontratën e Arsimit nr.01/B të datës 22.01.2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit padinë e kanë parashtruar në të njëjtën periudhë pra në vitin 2022, ndërsa kërkesëpadia rezulton e kërkuar nga viti 2019, që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë (09.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se **“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”** dhe Rregullores për tarifatat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë shumën prej 312.00 euro në emër të parashkrimit të padisë dhe shumën prej 20 euro në emër të taksës, ndërsa e refuzoi shumën prej 312.00 euro të kërkuar në emër të shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadiës sipas dispozitës së lartëcekur mbi shpenzimet procedurale.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152, dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.10 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.535/22 me datën 23.08.2024**

**G j y q t a r i**  
**Nehat Qelaj**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.